

Histori & diplomaci

ARMAND PLAKA

Duket disi paradoksale, e madje për shumëkënd edhe qesharake, por e vërtetë e njohur nga të gjithë. Sidomos nga brezi i baballarëve tanë. Duke hulumtuar në një studim të profesorit italian, dr. Giovanni Armillota ("The International Journal of Albanian Studies", Columbia University, New York, 1, 1997, N. 1, Fall: 69-81 / ALBANIA AND THE UNITED NATIONS: TWO CASES SEEN FROM A DIPLOMATIC HISTORY PERSPECTIVE), të cilit muaj më parë i kemi kushtuar edhe një numër të veçantë në gazetën tonë (Shqipëria, rol unik gjatë Luftës së Ftohtë; botuar në "Sqip", më 28 maj 2006), hasim në pjesën e fundit të studimit të tij të bazuar në arkivat e OKB-së në Nju Jork, ku bëhet fjalë për rolin e veçantë e tepër aktiv të diplomacisë shqiptare gjatë viteve '60-të e fillimviteve '70-të në lidhje me pranimin e R.P. të Kinës në OKB.

Por le të kalojmë tani direkt në temën tonë e të shohim më në thellësi se ç'na sugjerojnë dokumentet e arkivave të Pallatit të Qelqtë dhe cila ishte situata politiko-diplomatike e kohës kur ndodhi anëtarësimi i Republikës së Kinës në OKB me ndihmën e "Shqipërisë së vogël". Sigurisht që kjo gjë erdhi si rezultat, së pari, edhe i ndryshimit të erërave në politikën e jashtme të të dyja vendeve asokohe, pra afrimi amerikano-kinez e thyerja e akujve, por nga materiali që ne kemi zgjedhur sot për botim, nxirret qartë në pah përpjekja profesionale e diplomacisë shqiptare të asaj kohe, e vlerësohet ana interpretative e kësaj çështjeje nga delegacioni shqiptar e kreu i saj, si dhe përpjekjet e shumta diplomatike të vazhdueshme të Tiranës zyrtare në kryeqytetet më në zë të botës.

Shumë shtete, si India në 1950 dhe Bashkimi Sovjetik në 1961 dhe 1962, ishin përpjekur ta anëtarësonin Republikën Popullore të Kinës (Kinën kontinentale pra, dhe jo Republikën e Kinës, ose ndryshe Tajvanin) në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillin e Sigurimit dhe kishin dështuar.

Beteja diplomatike për Kinën

Në fillim të vitit 1963, Shqipëria, qysh prej kësaj kohe në marrëdhënie bilaterale shumë të ngushta me Kinën, përgatiti dhe paraqiti një seri prej tetë rezolutash, të cilat njëra pas tjetrës (përvëç vitit 1964) u diskutuan vazhdimisht disa herë deri në vitin 1971, vit kur Pekini u njoh e drejta të përfaqësonte Kinën në OKB. Beteja diplomatike tetëvjeçare që Shqipëria bëri në Nju Jork nuk ishte e përqendruar vetëm në bindjen e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për njohjen e Pekinit si përfaqësuesi zyrtar i më se 700 milionë njerëzve që jetonin asokohe në Kinë, por së pari, që të zgjidhej edhe një çështje tjetër e rëndësishme, për sa i përket kësaj rezolute: një aneks në të, ku të sanksionohej se përfaqësuesi i popullit kinez edhe në Tajvan do të ishte tashmë jo Çang Kai Shija, por Republika Popullore e Kinës. Më 15 dhjetor 1961, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së aprovoi një projekt të SHBA-së (nënshkruerit përshinin edhe Australinë, Kolumbinë, Japoninë dhe Italinë) Rezolutën 1668 (XVI) që ftonte Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së "të vendoste, duke u bazuar në nenin 18 të Kartës së OKB-së, se çdo propozim që kishte si qëllim të ndryshonte përfaqësimin e Kinës do të konsiderohej "një çështje e rëndësishme". Kjo pra, theksonte tashmë faktin se një pranim eventual i mundshëm i R.P. të Kinës do të merrej vetëm "me një shumicë prej dy të tretash të anëtarëve prezentë në votimin për këtë çështje".

Garancitë për qeverinë kineze

Ashtu sikurse edhe e pamë, kontributi i Shqipërisë nuk konsistonte në pranimin e Kinës. Duhet të theksohet se në këtë kohë SHBA-ja, Ppresidenti Nikson dhe Sekretari i Shtetit, Henry Kissinger, ia kishin dalë

Dokumentet në arkivat e Pallatit të Qelqtë të OKB-së, debatet e forta mes Tiranës dhe Uashingtonit për përfshirjen e Pekinit në Kombet e Bashkuara dhe "loja" diplomatike në shërbim të shtetit gjigand, vijnë nëpërmjet studimit të Dr. Giovanni Armillota



Përpjekja shqiptare për anëtarësimin e Kinës në OKB

VOTIMI

Më 25 tetor 1971, çështja shkoi në votim. Për herë të parë në 11 vjet, dokumenti "Çështje e rëndësishme" nuk arriti të bëhet Rezolutë - Çështje e rëndësishme. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e refuzoi atë me 59 vota kundër, 55 pro e 15 abstenime. Urgjencia për konsultime rreth projektit shqiptar e detyroi kreun e delegacionit amerikan në OKB të kërkonte ta ndante çështjen e përjashtimit të Tajvanit nga ajo e pranimin të R.P. të Kinës, duke propozuar për ti vënë ato në votim të

25 tetor 1971, miratohet propozimi

ndarë. Përfaqësuesi amerikan kishte si synim të thyente frontin pro-Pekin. Madje, edhe tentativat e tij nuk dolën mjaft të frytshme në këtë drejtim, sepse u refuzuan me 61 vota kundër, 51 pro e 16 abstenime. Shqipëria arriti kështu përmbyshjen e projektit të saj dhe qëlimin e saj diplomatik. Asambleja e Përgjithshme e pranoi projektin

e saj me 76 vota pro, 35 kundër dhe 17 abstenime. Pas kësaj, Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, indoneziani Adam Malik, sugjeroi se, përderisa Asambleja e Përgjithshme e kishte shprehur vullnetin e saj kaq qartë, projekti për mospërjashtimin nuk do të nënshtruhej votimit. Në konkluzionet përfundimtare, propozimet shqiptare u

aprovan nga Komiteti i Përgjithshëm dhe për tri herë me radhë në tavolinë nga Asambleja e Përgjithshme. Kjo shënoi edhe një arritje prestigjioze diplomatike të nivelit të lartë për historinë e diplomacisë shqiptare të asaj kohe. Pavarësisht qëllimit që i shërbeu, e që për një kohë të gjatë as që u përmend më pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën, trajtuar nga aspekti profesional juridiko-diplomatik, kjo ngjarje përbën një arritje për diplomacinë shqiptare në tërësi.



Ish-lideri komunist kinez, Mao Ce Dun



Ish-lideri nacionalist kinez, Chang Kai Shi

të riformulimin politik amerikan në lidhje me marrëdhëniet me Kinën. Njëra nga garancitë që iu dha kryeministrit të atëhershëm kinez, Çu En Lai, ishte edhe (ri)pranimi i Kinës në OKB. Pyetja e mbetur pezull ishte statusi i Republikës së Kinës në Tajvan. Kishte mbështetje të vazhdueshme për teorinë kineze të dy Kinave në shumë kryeqytete të botës. Por akoma, numri i anëtarëve të OKB-së që nuk ishin dakord me rezolutën "Çështje e rëndësishme" shkoi në ngritje nga 4,2 për qind në vitin 1961, në 57,4 për qind në vitin 1971.

Interpretim juridik perfekt
Megjithë faktorët e tjerë të përfshirë në këtë çështje - (edhe një herë duhet të përmendim zbutjen e pozicionit diplomatik të SHBA-së në raport me Kinën në vitet 1970-1971) - menjëherë të bie në sy, padyshim, edhe suksesi i papritur i diplomacisë shqiptare. Ajo çfarë duket më interesante në pozicionin e Tiranës, nëse do të linim jashtë trajtimit tonë argumentet dhe konkluzionet historiko-politike të kohës, është interpretimi juridik perfekt i të ashtuquajturës "vexata questio" (çështje e rëndësishme). Ndërsa Nesti Nase, asokohe ministër i Jashtëm i RPSSH-së dhe kreu i delegacionit shqiptar bënë vërejtjet e tyre në seancën e 18 tetorit 1971. "Ajo me çfarë ne po merremi tashmë, nuk është as pranimi i një anëtarë të ri dhe as përjashtimi i një shteti tjetër. Ne po trajtojmë çështjen themelore të përfaqësimit të një shteti, i cili është prej kohësh anëtar i OKB-së dhe kjo çështje duhet të përcaktohet qartë nga një shumicë e thjeshtë në Asamblë [...] ndryshimi i emrit të një vendi të caktuar nuk ka të bëjë fare me statusin e tij të anëtarësisë. Ka shembuj të shumtë nga çështje të ngjashme në historinë e Kombeve të Bashkuara".

Debatet në Asamblenë e OKB-së

Njëri nga studiuesit e së drejtës ndërkombëtare, Italiani Benedetto Conforti, në studimin e tij "Le Nazioni Unite" (Kombet

e Bashkuara) thekson se "është më se e qartë se çështja kineze nuk duhet të konsiderohet një kategori e veçantë, por një rast i veçantë konkret: pikërisht kur Shqipëria po debatonte aq shpesh [...]". Më 15 qershor 1971, Shqipëria dhe gjashtëmbëdhjetë vende të tjera nënshkruese kishin kërkuar që Asambleja e Përgjithshme të merrte në shqyrtim "Çështjen e rivendosjes së të drejtës legjitime të R. P. Kinës në OKB" (Retablissement des droits légitimes de la République Populaire de Chine a

l'Organisation des Nations Unites). Kjo çështje u përshi në rendin e ditës të Sesionit XXVI të Rregullt të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork, nga 21 shtatori deri më 22 dhjetor 1971. Kësaj çështjeje gjatë procesit iu bashkëngjiten edhe gjashtë anëtarë të rinj. Më 17 gusht, Kombet e Bashkuara prezantuan shtesën për sa i përket kësaj çështjeje "The Representation of China in the United Nations", ku theksohej qartë se Republika e Kinës duhet të përfaqësohet dhe në të njëjtën

Ashtu sikurse edhe e pamë, kontributi i Shqipërisë nuk konsiston në pranimin e Kinës. Duhet të theksohet se në këtë kohë SHBA-ja, Presidenti Nikson dhe Sekretari i Shtetit, Henry Kissinger, ia kishin dalë të riformulimin politikën amerikane në lidhje me marrëdhëniet me Kinën. Pyetja e mbetur pezull ishte statusi i Republikës së Kinës në Tajvan

Kina dhe Tajvani

Tirana dhe loja e rrezikshme me pavarësinë

Në fakt, çështja e njohjes së një Kine të vetme ka ngjallur shpesh debate dhe vazhdon të ngjallë edhe sot e kësaj dite, duke u shndërruar kështu shpesh në një lojë të vërtetë (shpesh të rrezikshme) jo vetëm për to. Viktimë e kësaj loje patën rënë edhe politikanë të veçantë të Tiranës, të cilët para disa vitesh ndërmorën edhe një udhëtim drejt Tajvanit dhe u takuan atje me autoritet më të larta të vendit, që u rezervuan atyre një pritje të veçantë. Duke u nisur, sigurisht, nga premtimet për ndihma të konsiderueshme financiare që ky vend u bënte herë pas here shteteve, të cilat do ta njihnin atë si "Sovran" jashtë juridiksionit kinez, u nis kështu drejt Tajvanit edhe një delegacion i Parlamentit Shqiptar, i përbërë nga deputetë të dy partive të ndryshme. Një pjesë e atmosferës dhe andrallave që përjetoi ky grup përshkruhen mirë edhe në librin e Nikollë Lesit "Si i njoha Nanon dhe Berishën", ku vetë autori pohon se nuk dinte asgjë deri më atëherë rreth "Çështjes së Tajvanit". Por rishikimi i pozicionit të tyre, që binte ndesh me atë zyrtar të shtetit e qeverisë së Shqipërisë në lidhje me këtë çështje, e cila dëshmohej si jetike për R.P. të Kinës, me të cilën Shqipëria ka një volum të madh këmbimesh ekonomike e të shumanshme, bënë që "përkrahja" e tyre ndaj Tajvanit të harrohej shpejt si kripa në ujë. Ndërkohë që Kina e njeh si të padiskutueshme të drejtën e saj mbi Tajvanin në të gjitha planet, përfshirë këtu edhe përfaqësimin e tij në OKB e organizmat ndërkombëtarë, Tajvani vetë duket se ka bërë përpjekje shumë të mëdha për të (ri)fituar njohje ndërkombëtare si shtet i pavarur nga R.P. e Kinës. Në fakt, ndarja nisi në kohën kur, në vitin 1949, rivali nacionalist i Mao Ce dunit, Chang Kai Shi, u detyrua të zhvendosej në ishullin e Tajvanit e të (ri)themelonte atje Republikën e Kinës, antipod i Republikës Popullore të Kinës, themeluar nga kundërshtari i tij komunist në pjesën kontinentale ku banojnë sigurisht, thuajse shumica absolute e popullit kinez.

kohë, kjo duhej të bëhej në një mënyrë ku të sigurohej se Republika e Kinës (Tajvani) nuk privohej nga pasja e një vendi në OKB. Më 22 shtator 22, përfaqësuesit e SHBA-së i propozuan Komitetit të Përgjithshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që të dyja çështjet të përziheshin në një të vetme nën emrin "Çështja kineze". Kërkesa e tyre u refuzua me 12 kundra, nëntë të favor dhe tre abstenime.

Përplasjet Tiranë-Uashington
Debat i ndezi një duel politik midis Ti-

ranës e Uashingtonit, një debat që do të karakterizonte gati të gjitha fazat e operacionet e procesit të votimit me përpjekje e zell të madh nga të dyja palët. Kreu i delegacionit amerikan e mbronte projektin "çështje e rëndësishme" dhe e stigmatizonte Shqipërinë si anti-universaliste, duke nënvizuar refuzimin e Shqipërisë për të pranuar përfaqësimin e Tajvanit në OKB. Shqiptarët ishin kundër "Teorisë së dy Kinave" dhe pro asaj të "Një Kine e një Tajvani".

Megjithë faktorët e tjerë të përfshirë në këtë çështje - (edhe një herë duhet të përmendim zbutjen e pozicionit diplomatik të SHBA-së në raport me Kinën në vitet 1970-1971) - menjëherë të bie në sy, padyshim, edhe suksesi i papritur i diplomacisë shqiptare



Plakati karakteristik i epokës moniste në një rrugë të Shqipërisë

Tajvani

Tigri ekonomik i Azisë

Tajvani është një ishull në Azinë Lindore, por ky term shpesh u referohet edhe territoreve të qeverisura nga ajo që njihet si Republika e Kinës (ROC), të cilat përfshijnë ishujt e Tajvanit, Lanyu (ishulli i Orkideve) dhe Gjelbër në brigjet e Paqësoris, Pescadores, dhe Kinmen e Matsuo që ndodhen në brigjet juglindore të Republikës Popullore të Kinës. Sipërfaqja totale e tij arrin në 3,706,566 kilo-

metër katrorë e popullsia nëmbi 22 milionë banorë. Ndërsa vendi deri në vitin 1975 u qeveris në mënyrë diktatoriale, pas vdekjes së liderit nacionalist kinez, Cheng Kai Shi, në vitin 1975, nisi një erë liberalizmi në vend. Në aspektin ekonomik, Tajvani ishte bërë me kohë një nga ata që njihen si "Tigrat e Azisë" pas bumit të përjetuar në vitet '60-'70, nivel të cilin ai vazhdon ta mbajë edhe sot e kësaj dite.

